

VENDIM
Nr. 18, datë 20.1.2021

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË FILLUAR ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 235, DATË 15.12.2020 “MBI FILLIMIN E
PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 369, SERIA TGN17, PËR
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR, DHËNË SHOQËRISË
“C.G.C” SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 73, DATË 16.5.2017**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 95, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neneve 8 dhe 9 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë Elektrike (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017, si dhe nenit 16 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.1.2021, pasi shqyrtoi relacionin nr. 9/9 prot., datë 16.1.2021, të përgatitur nga grupi i punës, “Mbi përfundimin e procedurës administrative të filluar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 15.12.2020 ‘Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 369, seria TNG17, për veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror, dhënë shoqërisë ‘C.G.C’ sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73, datë 16.5.2017””,

KONSTATOI SE:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 235, datë 15.12.2020, vendosi për fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 369, seria TGN17, për veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror, dhënë shoqërisë “C.G.C” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE nr. 73, datë 16.5.2017.

- Vendimi i Bordit të ERE nr. 235, datë 15.12.2020, i është dërguar për dijeni shoqërisë C.G.C sh.p.k., nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1172/11-1 prot., datë 23.12.2020.

- Në vijim të këtij njoftimi, më datë 13.1.2021, nga verifikimet e Drejtorisë së Financës në ERE rezultoi dhe u bë me dije se, janë shlyer detyrimet për pagesat e rregullimit për të cilat rezulton debitore shoqëria.

- Referuar afateve të përcaktuara nga ERE në njoftimin e dërguar për dijeni të subjektit, rezulton se subjekti ka shlyer detyrimet e prapambetura brenda afatit të përcaktuar në këtë njoftim e të sanksionuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235/2020.

- Për sa më sipër, rezulton se shoqëria “C.G.C” sh.p.k. nuk është debitore ndaj ERE-s për pagesat e prapambetura të rregullimit.

- Në nenin 8 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se: pas marrjes së përgjigjes më shkrim nga i licencuari sipas parashikimeve, personat e ngarkuar që ndjekin këtë procedurë, do të shqyrtojnë këtë përgjigje brenda 30 ditëve dhe do të përgatisin një relacion për Bordin mbi argumentet e paraqitura dhe veprimet e ndërmarra nga i licencuari dhe do t'i propozojnë Bordit: a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës në rast se i licencuari dëshmon mungesën e kushteve të përcaktuara në pikat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe/ose “d”, të nenit 5, të kësaj rregulloreje.

- Në nenin 95 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim

përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”.

- Dispozitat e nenit 95 zbatohen për çdo procedurë administrative, pavarësisht nëse është filluar kryesisht nga organi publik ose me kërkesë të palës. Në këtë rast, “qëllimi” i procedurës lidhet ngushtësisht me marrjen e masave ligjore kryesisht nga organi që ka kompetencën, me qëllim shmangien e faktorit që ka nxitur vendimmarrjen.

- Vërtetimi i shlyerjes së pagesave të prapambetura, faktori ndryshimin e statusit të subjektit të cilit i kundërdrejtohet masa administrative duke rezultuar në rënien e shkakut që imponoi marrjen e masës ligjore.

- Në nenin 9, germa “a”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se: “Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas neneve 7 dhe 8, të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë: a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës administrative të filluar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 15.12.2020, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 369, seria TGN17, për veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror, dhënë shoqërisë ‘C.G.C’ sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73, datë 16.5.2017”.

2. Shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 235, datë 15.12.2020, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 369, seria TGN17, për veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror, dhënë shoqërisë ‘C.G.C’ sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73, datë 16.5.2017”.

3. Grupi i punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti